



MINISTRJA KUSHI NË UPT: E LUMTUR PËR RITJEN E PAGAVE TË PEDAGOGËVE



Në takim të zhvilluar me staf akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës, Ministri Kushi diskutoi dhe ndau opinionet për politikën dhe projektet që lidhen me përmirësimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Zonja Kushi foli edhe për rritjen e pagave të pedagogëve për herë të dytë brenda një periudhe të shkurtër.

KUSHI: SHQIPËRIA, E DYTË NË RAJON PËR ARRITJET ARSIMORE NGA TESTI PIRLS 2021



Nga Testi PIRLS 2021 i Organizatës Ndërkombëtare për Vlerësimin e Arritjeve Arsimore, Shqipëria ka marrë rezultatet më të mira ndonjëherë në renditjet ndërkombëtare në arsim. Ministri e Arsimit dhe Sportit, Evis Kushi tha se në këtë testim Shqipëria ka marrë 513 pikë dhe është renditur e dyta në rajon me vetëm 1 pikë diferencë nga vendi i parë që është Serbia.



DITARI MUJOR

Maj 2023



SHQIPËRIA MBËSHTET KANDIDATURËN E KOSOVËS PËR LOJËRAT MESDHETARE 2030



Shqipëria do ta mbështesë kandidaturën e Kosovës organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Ministria Kushi dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, Hajrulla Çeku nënshkruan marrëveshjen, ku Shqipëria angazhohet për të mbështetur Kosovën në procesin e përgatitjes dhe organizimit të garave të sportit të lundrimit.

MINISTRJA KUSHI PREMTON SË SHPEJTI KARTËN E STUDENTIT PËR UNIVERSITETIN E ELBASANIT



Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Bashkia e Elbasanit do të nënshkruajnë së shpejti një marrëveshje për kartën e studentit për studentët e Universitetit të Elbasanit. Ministria u shpreh se me Bashkinë Elbasan tashmë është rënë dakord që në javët në vijim të nënshkruhet marrëveshja për kartën e studentit për studentët në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit.



DITARI MUJOR

Maj 2023

MINISTRJA KUSHI MESAZH TË FORTË DIASPORËS NGA TORINO: TA MBROJMË ME FANATIZËM GJUHËN SHQIPE!



Gjatë fjalës së saj në takim të titulluar “Letra nga Diaspora”, Ministria Kushi nënvizoi rëndësinë e mbrojtjes dhe përhapjes së gjuhës shqipe, duke thënë se një shtet pa gjuhën e tij nuk ka identitet, nuk ka histori, nuk ka as të ardhme, ndaj dhe shqipja duhet mbrojtur dhe mësuar me fanatizëm.

ZGJEROHET PROGRAMI READ I DIASPORËS AKADEMIKE /KUSHI: KONTRIBUTI I AKADEMIKËVE I RËNDËSISHËM



Ministrja e Arsimit dhe Sportit Evis Kushi mori pjesë në një aktivitet ku u prezantua zgjerimi i programit READ (Ekspertiza e Kërkimit nga Diaspora Akadematike) nga 10 universitete në 15 universitete në të gjithë vendin. Ministria vlerësoi kontributin e akademikëve të diasporës për arsimin e lartë.

 @eviskushi

 @kushievis

 @eviskushi